



**Zëri yt është i rëndësishëm.**  
Reago dhe raporto diskriminimin!



## A e dini se çfarë paraqet diskriminimi?

Diskriminimi është çdo trajtim i pabarabartë i një personi ose grupi njerëzish.

Diskriminimi në thelb ka për qëllim pengimin e realizimit të të drejtave dhe lirive të një personi ose një grupi njerëzish në të njëjtën situatë ose të ngjashme me të tjerët.

Trajtimi diskriminues bazohet në disa karakteristika personale ose grupore si raca, ngjyra, origjina, përkatësia kombëtare ose etnike, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, origjina sociale, paaftësia, mosha, statusi familjar ose martesor, ose cilado bazë tjetër disiriminuese.

## Pse ta raportosh diskriminimin?

Duke e raportuar diskriminimin dhe duke kërkuar mbrojtje para institucioneve, mund të merrni mbrojtje nga ata që i kanë shkelur të drejtat tuaja dhe diskriminuesit mund të dënohen sipas rregulloreve ligjore të RMV-së. Vetëm duke vënë në dukje rregullisht trajtimin e pabarabartë mes njerëzve, mund ta zvogëlojmë këtë praktikë të dëmshme sociale.

## A mund të kërkosësh mbrojtje nëse mendon se je i diskriminuar?

Diskriminimi është i ndaluar me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe me ligj të veçantë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

# Si ta njihni diskriminimin?

## Shembulli 1:

---

Një grua - fermere e regjistruar nga një mjedis rural nuk ka të drejtë për pushim të paguar të lehonisë dhe pushimit për shkak të sëmundjes, megjithëse i paguan rregullisht kontributet nga sigurimet sociale, shëndetësore, pensionale dhe invalidore.

## Shembulli 2:

---

Pasi punëdhënësi e ka kuptuar se ajo ishte shtatzënë, nuk ia ka rinovuar kontratën e punës, edhe pse punëtorja i ka kryer të gjitha detyrat e punës në kohë dhe me përgjegjësi.

**Ndalohen të gjitha format e diskriminimit të punëtores për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe mëmësisë, pavarësisht nga kohëzgjatja e marrëdhënies së punës.**

## Shembulli 3:

---

Një person me aftësi të kufizuara nuk mund të hyjë në një institucion të caktuar shtetëror dhe nuk mund të ushtrojë të drejtat e tij të garantuara për shkak se hapësira nuk është e përshtatur dhe godina ku ndodhet institucioni nuk ka rampë aksesit apo ashensor për karriget invalidore.

**Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses dhe lëvizje të papenguar deri te dhe në të gjitha ndërtesat për qëllime publike dhe afariste!**

## Shembulli 4:

---

Një person LGBTI ka denoncuar në polici se ka qenë viktimë e dhunës në familje dhe ka kërkuar mbrojtje nga policia. Kur kanë arritur oficerët e policisë dhe kur e kuptuan se viktima ishte homoseksual, jo vetëm që nuk vepruan dhe nuk e ndoqën çështjen, por filluan ta tallnin dhe ta nënçmojnë.

**Çdokush ka të drejtë për mbrojtje në rast të dhunës në familje, pavarësisht nga seksi, gjinia apo orientimi seksual dhe oficerët e policisë janë të detyruar të veprojnë në mënyrë profesionale, të paanshme dhe me kujdesin e duhur.**

## Shembulli 5:

---

Babait të një fëmije gjatë shtrimit në Klinikën e fëmijëve nuk i është lejuar ta shoqërojë fëmijën e tij gjatë mbrëmjes, pasi lejohet vetëm një shoqëruese femër – nënë, gjyshe, teze etj.

**Në repartet ku shtrohet një fëmijë me shoqërues, kjo e drejtë mund të përdoret në mënyrë të barabartë nga çdo prind apo kujdestar, pavarësisht gjinisë!**

## Shembulli 6:

---

Disa romëve nuk ju lejua hyrja në kafe-bar, për shkak të origjinës së tyre racore dhe etnike, me pretekstin se objekti i hotelarisë ishte i zënë, megjithëse kishte më shumë tavolina të lira.

**Çdo person ose grup ka të drejtën e aksesit të lirë në mallra dhe shërbime publike si restorantet, kafe-bar etj. pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike!**

# Ku të drejtohesh për mbrojtje nga diskriminimi?

- Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi – KPMD është organ i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi që vepron sipas parashtesave, jep mendime dhe rekomandime. Parashtesë për diskriminim mund t'i dorëzohet Komisionit në disa mënyra: në mënyrë elektronike në ueb faqen e tyre [www.kszd.mk](http://www.kszd.mk), përmes postës dhe personalisht në zyrat e KPMD-së në adresën e tyre në rr. “Dame Gruev” nr. 1, 1000 Shkup.
- Avokati i Popullit mbron nga diskriminimi kur ai kryhet nga autoritetet shtetërore dhe institucionet dhe shërbimet publike. Avokati i Popullit jep rekomandime, propozime, mendime dhe indikacione në rastet kur konstatohet diskriminim. Ankesa për diskriminim mund të dorëzohet tek Avokati i Popullit në disa mënyra: në mënyrë elektronike në ueb faqen e tyre [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk), përmes postës dhe personalisht në zyrat e Avokatit të Popullit në adresën e tyre në rr. “Maqedonia” nr. 19, 1000 Shkup, si dhe në zyrat rajonale në:

## **Manastir**

rr. “Jane Sandanski” p.n.,  
tel. 047/242-310

## **Kërçovë**

bul. “Çlirimi” p.n.,  
tel. 045/228-586

## **Shtip**

rr. “Tosho Arsov” p.n.,  
tel. 032/389-701

## **Tetove**

rr. “Ilindenska” nr. 85,  
tel. 044/344-081

## **Strumicë**

rr. “Mareshali Tito” p.n.,  
tel. 034/329-995

## **Kumanovë**

rr. “11 Tetori” p.n.,  
tel. 031/431-488

- Mbrojtja gjyqësore - Personi që beson se është diskriminuar mund të ngrejë padi pranë një gjykate civile kompetente. Procedura për mbrojtjen nga diskriminimi është urgjente. Personat që nisin procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi përjashtohen nga pagesa e tarifave gjyqësore.

# Ku mund të marrësh këshillë ligjore dhe ndihmë për mbrojtjen nga diskriminimi?

Ekzistojnë organizata qytetare që ofrojnë këshilla ligjore dhe ndihmë në mbrojtjen nga diskriminimi. Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me anëtarët e tij ofron informacione dhe këshilla bazë për mbrojtjen nga diskriminimi, asistencë në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm në paraqitjen e lëndëve para KPMD dhe AP dhe përfaqësimin në rastet e diskriminimit para gjykatave vendase dhe ndërkombëtare. Kontaktoni RRMD-në në adresën e mëposhtme të postës elektronike: [mrezazazastitaoddiskriminacija@gmail.com](mailto:mrezazazastitaoddiskriminacija@gmail.com), tel. +389 2 3214 269, ose në shoqatat e autorizuara për dhënien e NJF, anëtarë të RRMD-së, përkatësisht: Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (SHMJR) - Shkup, rruga "Donbas", nr. 14/1-6, 02/3220-870 [contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk) dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut - Shkup, rruga "Naum Naumoski Borçe" nr. 83, 02/3119-073, 02/3290-469, 072/278-436 [info@mhc.org.mk](mailto:info@mhc.org.mk).

## A ke të drejtë për avokat pa pagesë?

Nëse një person i cili për shkak të gjendjes së tij financiare nuk mund t'i realizojë të drejtat e garantuara me ligj, pa rrezikuar jetesën e tij dhe të familjarëve të tij, ai mund të përdorë sistemin e ndihmës juridike falas për mbrojtje nga diskriminimi.

Ndihma juridike falas mund të ofrohet si ndihmë juridike primare dhe ndihmë juridike sekondare. Ndihma juridike primare ofrohet nga Ministrinë rajonale të Drejtësisë, shoqatat e autorizuara dhe klinikat juridike, ndërsa ndihma juridike sekondare ofrohet nga avokatët në procedurat gjyqësore. Personit të cilit i jepet ndihma juridike sekondare i caktohet avokat, lirohet nga pagesa e taksave dhe shpenzimeve gjyqësore lidhur me procedurën para gjykatës, lirohet nga shpenzimet për ekspertizë dhe shpenzimet administrative. Mjetet financiare në procedurat e parapara me Ligjin për ndihmën juridike falas sigurohen nga Ministria e Drejtësisë.

# Çfarë kushtesh duhet t'i plotësosh që të mund ta përdorësh ndihmën juridike sekondare?

- Të ardhurat mujore të aplikantit dhe anëtarëve të familjes së tij nuk duhet të kalojnë shumën e pagës minimale neto të përcaktuar dhe të ardhurat mujore të çdo anëtari të mëpasshëm nuk duhet të kalojnë shumën prej 20% të pagës minimale neto të përcaktuar;
- Aplikanti dhe anëtarët e familjes së tij zotërojnë vetëm një objekt ose apartament njëdhomëshe në të cilën jetojnë;
- Aplikanti dhe anëtarët e familjes së tij duhet të posedojnë një ose më shumë parcela kadastrale të lidhura fizikisht me sipërfaqe totale prej jo më shumë se 300 m<sup>2</sup> në qytetin e Shkupit ose 500 m<sup>2</sup> në komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, d.m.th. një ose më shumë parcela kadastrale me një sipërfaqe totale jo më shumë se 5000 m<sup>2</sup> në zonat rurale dhe
- Aplikanti për ndihmë juridike dhe anëtarët e familjes së tij duhet të kenë vetëm një automjet të regjistruar, kapaciteti i motorit të të cilit nuk i kalon 1200 centimetra kub.



# Ku mund të aplikosh për ndihmë juridike falas?

Kontakttoni Departamentet rajonale për ndihmë juridike falas të Ministrisë së Drejtësisë ose Shoqatat e autorizuara të ndara sipas rajoneve planifikuese në RMV:

## Rajoni Jugperëndimor

Kërçovë, Dibër, Strugë dhe Ohër

---

### Zyra Kërçovë

rr. "Boris Kidriç" nr. 1, 6250

071/224-652

### Zyra Dibër

rr. "8 Shtatori" p.n., 1250

071/223-768

### Zyra Strugë

rr. "Brigadat Proletare" p.n., 6330

071/223-015

### Zyra Ohër

rr. "Dimitar Vllahov" nr. 57, 6000

071/221-908

## Rajoni Juglindor

Strumicë dhe Gjevgjeli

---

### Zyra Strumicë

rr. "Sando Masev" nr. 1, 2400

071/224-526

### Zyra Gjevgjeli

rr. "Mareshali Tito" nr. 170, 1480

071/224-678

### Shoqata e qytetarëve "Izbor" – Strumicë

f. Banicë nr. 220

075/495-470, 076/453-808, 075/495-473

## Rajoni Verilindor

Kumanovë dhe Kriva Pallankë

---

### Zyra Kumanovë

rr. "11 Tetori" p.n., 1300  
071/227-962

### Zyra Kriva Pallankë

rr. "Sh. Joakim Osogovski nr. 17, 1330  
071/224-580

### Shoqata Qendra Kombëtare Rome, Kumanovë

rr. "Done Bozhinov" nr. 11/5  
031/427-558

## Rajoni Lindor

Shtip, Koçanë dhe Berovë

---

### Zyra Shtip

rr. "Vasil Glavinov" nr. 4, 2000  
070/821-089

### Zyra Koçanë

rr. "Rade Kratovçe" nr. 1, 2300  
071/221-580

### Zyra Berovë

rr. "Dimitar Vllahov" nr. 10, 2330  
071/20-324

### Shoqata EHO Organizatat Edukative - Humanitare Shtip

rr. "Todor Kollarov" nr. 26  
032/384-143, 032/607-143

### Organizata joqeveritare "KHAM" Dellçevë

rr. "Mareshali Tito" nr. 69  
071/215-356

## Rajoni i Pollogut

Tetovë dhe Gostivar

---

### Zyra Tetovë

rr. "Dervish Cara" nr. 68, 1200  
070/964-305

### **Zyra Gostivar**

rr. "Vëllezërit Ginoski" p.n., 1230  
072/780-387

### **Shoqata e Grave Forum - Tetovë**

rr. "Nikolla Tesla" nr. 6  
044/337-440, 044/343-410

## **Rajoni i Pellagonisë**

Prilep, Resnjë dhe Manastir

---

### **Zyra Prilep**

rr. "Joakim Stojkoski" nr. 1, 7500  
075/541-832

### **Zyra Resnjë**

Sheshi "Mbreti Samoill" p.n., 6310  
071/221-246

### **Zyra Manastir**

Bul. "1 Maji" p.n., 7000  
071/223-392

### **Qendra rinore kulturore Manastir**

rr. "Mbreti Samoill" nr. 29  
047/233-020

### **Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm SFERA Interneshenëll – Manastir**

rr. "Vllatko Milenkoski" nr. 22  
074 245 154

## **Rajoni i Vardarit**

Veles dhe Kavadar

---

### **Zyra Veles**

rr. "Panko Brashnar" p.n., 1400  
078/243-054

### **Zyra Kavadar**

Sheshi "Mareshali Tito" p.n., 1430  
075 659 855

### **Shoqata "Organizata e Grave të Komunës së Sveti Nikoles"**

rr. "Leninova" nr.1 -1/4  
077/653-637

# Zëri yt është i rëndësishëm. Reago dhe raporto diskriminimin!



*Citizens for change!*



Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Koalicionit "Margjina" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Civica mobilitas, Ambasadës Zvicerane ose organizatave të saj zbatuese.